



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 48, Datë 27.02.2025

MBI

MIRATIMIN E DISA SHITESAVE DHE NDRYSHIMEVE NË “PROCEDURAT REZERVË PËR BASHKIMIN E TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË DITËS NË AVANCË SHQIPËRI – KOSOVË”

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nën pikës 3.5 të pikës 3 të Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 519, datë 13.07.2016 “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 3, pika 8 të Rregullores së kërkesave dhe procedurave për përcaktimin e Operatorit të Emëruar të Energjisë Elektrike (NEMO) si dhe rolet e përgjegjësitë e NEMO dhe Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë në tregun e bashkuar, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 40, datë 06.03.2020; neneve 15 dhe 26 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; si dhe “Marrëveshjes kornizë mbi bashkimin e tregjeve të energjisë elektrike të Shqipërisë dhe Kosovës” të datës 21.10.2021, nënshkruar nga ERE, Zyra e Rregullatorit për Energji e Kosovës (ZRRE), Operatori i Sistemit të Transmetimit të Shqipërisë (OST) sh.a., dhe Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Kosovës (KOSTT) sh.a; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.02.2025, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 1191 prot., datë 25.02.2025 të përgatitur nga Drejtoritë Teknike “Mbi miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në “Metodologjinë e shpërndarjes së të ardhurave nga kongjestioni i energjisë elektrike ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës” dhe “Procedurat rezervë për bashkimin e tregut të energjisë elektrike të ditës në avancë Shqipëri - Kosovë”,

Konstatoi se:

- OST sh.a., me shkresën nr. 4536/4 prot., datë 31.10.2024, ka përcjellë për shqyrtim disa shtesa dhe ndryshime në “Metodologjinë e shpërndarjes së të ardhurave nga kongjestioni i energjisë elektrike ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës”, miratuar me vendimin nr. 100, datë 27.05.2024, të bordit të ERE, si dhe në “Procedurat rezervë për bashkimin e tregut të energjisë elektrike të ditës në avancë Shqipëri-Kosovë”, miratuar me vendimin nr. 101, datë 27.05.2024, të bordit të ERE.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 250, datë 25.11.2024, vendosi: *Fillimin e procedurës për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në “Procedurat Rezervë për Bashkimin e Tregut të Energjisë Elektrike të Ditës në Avancë Shqipëri – Kosovë”.*

- Vendimi nr. 250/2024 i është komunikuar palëve të interesit me shkresën nr. 1899/4 prot., datë 27.11.2024. Gjithashtu, shtesat dhe ndryshimet e propozuara janë publikuar në seksionin “Konsultime” të faqes zyrtare të internetit të ERE-s dhe deri në këtë vendimmarrje nuk kemi marrë asnjë koment nga ndonjë palë e interesuar.
- Ndryshimet e propozuara nga OST sh.a. synojnë të përmirësojnë këto rregulla duke përfshirë edhe tregun brenda ditës (IDA) krahas tregut të ditës në avancë, si më poshtë vijojnë;
 - *Titulli: Shtohet referenca për tregun e energjisë brenda ditës.*
Pjesa hyrëse:
 - *Pika 5: Shtohet qartësimi se në rast të mungesës së rezultateve nga tregu i ditës në avancë, edhe IDA do të ketë një sistem të përbashkët komunikimi rezervë.*
 - *Pika 7: Procedura rezervë do të zbatohet edhe për tregun brenda ditës, duke përfshirë një sistem komunikimi rezervë.*
 - *Pika 9: Afati i zbatimit të procedurave rezervë do të përfshijë edhe IDA.*
 - *Neni 1, pika 1 (Objekti dhe fushëveprimi): Shtohet qartësimi se procedurat rezervë vlejnë edhe për IDA, duke siguruar një sistem të përbashkët komunikimi rezervë.*
- Këto ndryshime synojnë të harmonizojnë proceset e alokimit të kapaciteteve dhe menaxhimit të kongjestioni.
- Në propozimet e shtesave dhe ndryshimeve të "Procedurat rezervë për bashkimin e tregut të energjisë elektrike të ditës në avancë Shqipëri - Kosovë", saktësohet se në pjesën hyrëse pika 5 i referohet pikës 6 dhe pika 9 i referohet pikës 10. Në këto kushte, shtesat dhe ndryshimet e sipërcituara do të miratohen, me korrigjimet e lartpërmendura.
- Shtesat dhe ndryshimet e propozuara nga OST sh.a. pasqyrojnë kërkesat e nevojshme për zbatueshmërinë e këtyre dokumenteve edhe në tregun e organizuar të energjisë elektrike brenda së njëjtës ditë duke zgjeruar fushën e tyre të veprimit, duke përfshirë edhe tregun brenda së njëjtës ditë të Bursës Shqiptare të Energjisë.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në “Procedurat Rezervë për Bashkimin e Tregut të Energjisë Elektrike të Ditës në Avancë Shqipëri – Kosovë” si më poshtë vijon:
 - **Titulli** ndryshon dhe bëhet: Procedurat Rezervë për Bashkimin e Tregut të Energjisë Elektrike të Ditës në Avancë dhe Bashkimin e Tregut të Energjisë Elektrike Brenda së Njëjtës Ditë Shqipëri – Kosovë.
 - **Pika 6** ndryshon dhe bëhet: *Këto procedura rezervë janë një propozim i përbashkët, i zhvilluar nga OST dhe KOSTT si Operatorë të Sistemit të Transmetimit, të cilët synojnë të*

sigurojnë alokim efikas, transparent dhe jodiskriminues të kapaciteteve, në rast se procesi i bashkimit të tregut të ditës në avancë Shqipëri – Kosovë nuk është në gjendje të prodhojë rezultate, si dhe për IDA (bashkimin e tregut të energjisë elektrike brenda së njëjtës ditë Shqipëri – Kosovë) për një sistem të përbashkët komunikimi rezervë.

- **Pika 7** ndryshon dhe bëhet: *Procedurat rezervë mbajnë në konsideratë dispozitat mbi parimet e përgjithshme të pasqyruara në Rregulloren e Komisionit (BE) 2015/1222 të 24 Korrikut 2015, për krijimin e një udhëzuesi për alokimin e kapaciteteve dhe menaxhimin e kongestionit (“Rregullorja CACM”). Ndërsa për IDA (bashkimin e tregut të energjisë elektrike brenda së njëjtës ditë Shqipëri – Kosovë), procedura rezervë do të zbatohet për një sistem të përbashkët komunikimi rezervë.*
- **Pika 10** ndryshon dhe bëhet: *Këto procedura rezervë për bashkimin e tregut të ditës në avancë Shqipëri – Kosovë dhe IDA (bashkimin e tregut të energjisë elektrike brenda së njëjtës ditë Shqipëri – Kosovë), të propozuara nga OST-të përkatëse, siç kërkohet nga Neni 7.3 (c) i Marrëveshjes Kornizë, i paraqiten për miratim Rregullatorëve përkatës, në përputhje me Nenin 6 të Marrëveshjes Kornizë.*
- **Neni 1, pika 1**, ndryshon dhe bëhet: *1. Procedurat rezervë, siç përcaktohen këtu, do të konsiderohen si propozim i përbashkët i OST-ve AL-KS për të siguruar alokim efikas, transparent dhe jodiskriminues të kapaciteteve, në rast se procesi i bashkimit të tregut të ditës në avancë nuk është në gjendje, plotësisht ose pjesërisht, të prodhojë rezultate, në përputhje me aktet ligjore, nënligjore, rregullatore dhe marrëveshjet midis OST-ve dhe NEMO-s të Shqipërisë dhe Kosovës, si dhe për IDA (bashkimin e tregut të energjisë elektrike brenda së njëjtës ditë Shqipëri – Kosovë) për një sistem të përbashkët komunikimi rezervë.*

2. Drejtoria e Zhvillimit të Politikave dhe Mbikëqyrjes së Burimeve të Rinovueshme, të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijani, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI